

Lëshimi i vizës afatshkurtër, tip C

Përshkrimi

Pajisja e të huajve me vizë për motive turistike, tip C.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Formulari i aplikimit;
- 2) Fotografi për pasaportë, jo më e vjetër se 6 muajt e fundit;
- 3) Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, (i cili duhet të jetë me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar);
- 4) Sigurimi shëndetësor, për të gjithë kohëzgjatjen e vizës;
- 5) Për fëmijët, deklaratë ku shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestari ligjor për udhëtimin e fëmijës, ose personi që e ka në ngarkim;
- 6) Ftesa e nënshkruar nga ftuesi;
- 7) Për vizë C me motiv turizëm, duhet edhe:
 - Dokumentin e rezervimit vajtje-ardhje të biletës;
 - Prenotim hoteli ose dokumente në lidhje me strehimin gjatë qëndrimit;
 - Dokumente që provojnë se ka mjete të mjaftueshme financiare për qëndrim dhe kthim në vendin e origjinës;
- 8) Për vizë të tipit C, me motiv turizëm të organizuar në grupe turistike duhet edhe:
 - Fotokopje pasaporte;
 - Fotokopjen e noterizuar të licencës të shoqërisë turistike shqiptare, e cila fton grupin e huaj turistik;
- 9) Për vizë të tipit C, për motive shkencore, kulturore, sportive dhe humanitare duhet edhe:
 - Ftesa nga subjekti pritës;
 - Rezervimi i hotelit apo deklarata e mikpritjes;
 - Mjete të mjaftueshme financiare që mbulojnë kohën e qëndrimit dhe kthimin në vendin e origjinës;
- 10) Për vizë të tipit C, për motive zyrtare duhet dhe:
 - Ftesë nga institucioni pritës;
 - Notë verbale nga institucioni ku i huaji është i punësuar;
- 11) Për vizë të tipit C, për motive mjekësore duhet dhe:
 - Ftesë nga institucioni pritës;
 - Epikrizë (origjinale ose fotokopje) të lëshuar nga vendi pritës;
 - Deklaratë e institucionit spitalor në Shqipëri për detajet e trajtimit mjekësor si dhe subjekti që do t'i mbulojë këto kosto;
 - Mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet;
 - Sigurim shëndetësor për shoqëruesit e të sëmurit
- 12) Për vizë të tipit C- për motive profesionale, tregtare dhe biznesi
 - Ftesën nga subjekti pritës;
 - Dokument që provon veprimtarinë profesionale tregtare me të cilin lidhen motivet e vizitës;
 - Dokumente që provojnë statusin juridik të subjektit tregtar;
 - Fotokopje e certifikatës së regjistrimit në punë për vizat nga 60-90 dite;

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale (të paktën kur kryen për herë të parë aplikimin

- 2) Plotësimi i formularit të vizës);
- 3) Plotësimi i formularit të vizës për fëmijë bëhet nga njeri ose dy prindërit, ose kujdestari ligjor ose personi që e ka në ngarkim;
- 4) Paraqitja personale për marrjen e vizës;

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Me reciprocitet, në bazë të VKM 513/13;
- 2) Pa tarifë trajtohen:
 - Fëmijët deri 6 vjeç;
 - Mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit;
 - Anëtarët e organizatave jofitimprurëse nën 25 vjeç;
 - Nxënësit e shkollave, studentët, studentët pasuniversitare për motive studimi ose trajnimi arsimor;
 - Studiues që kryejnë kërkime shkencore;
 - Raste humanitare;
- 3) Me tarifë të përgjysmuar trajtohen vizat për fëmijët nga 6-12 vjeç;
- 4) Afati i lëshimit të vizës zgjat deri në 15 ditë dhe për raste përjashtimore deri në 30 ditë.

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.

Shënime

Marrja e vizës nuk është garanci që të huajt t'i lejohet hyrja në Republikën e Shqipërisë. Në rastet kur fëmijët nuk kanë pasaportë, viza shënohet në vizën e prindit ose të kujdestarit ligjor, në pasaportën e të cilit është shënuar.

Pas refuzimit të vizës i huaji ka të drejtë të riaplikojë vetëm pasi të ketë mbyllur procedurën e apelimit ose pasi të kenë kaluar tre muaj nga data e marrjes së vendimit për refuzim.

- 1) Përfshihen nga detyrimi i paraqitjes për aplikim në përfaqësi kategoritë:
 - Mbajtësit e pasaportave diplomatike;
 - Rastet humanitare;
 - Personalitetet e larta shtetërore, bashkëshortët e tyre shoqërues si dhe delegacionet që i shoqërojnë në vizitat zyrtare;
 - I huaji me titull mbretëror dhe anëtarë të tjerë të familjes mbretërore në vizitat zyrtare;
 - Të huajt e organizuar në grupe turistike;
 - Të huajt të cilët kanë aplikuar vetë më parë për një afat prej 59 muajsh.
- 2) Të huajt që vjen nga vende të prekura nga epidemi ose sëmundje, në Pikën e Kalimit Kufitar, i kërkohet kartela origjinale e vaksinimit ndërkombëtar.

[Formulari për aplikimin për vizë.](#)